

STANDARDET NDËRKOMBËTARE DHE SFIDAT E GARANTIMIT TË LIRISË SË MEDIAS

Nga Erlona Haxhiaj, Juriste

Publikuar në dt.2 Nëntor 2022

Ky Punim është realizuar nga praktikantja e Komitetit Shqiptar të Helsinkit (KShH), Erlona Haxhiaj, përgjatë realizimit të praktikës profesionale tre mujore pranë Zyrave të KShH-së. Opinionet, konkluzionet dhe rekomandimet e shprehura në këtë punim janë përgjegjësi e Autores (Erlona Haxhiaj) dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht ato të KShH-së.

Tabela e lëndës

STANDARDET NDËRKOMBËTARE DHE SFIDAT E GARANTIMIT TË LIRISË SË MEDIAS	1
Nga Erlona Haxhiaj, Juriste	1
1. Hyrje	3
1.1. Zbatimi i standardeve ndërkombëtare në këtë fushë	3
1.2. Sfidat e vazhdueshme të lirisë së medias në Shqipëri	5
2. Jurisprudenca e GJEDNJ	6
2.1. Legjislacioni Shqiptar lidhur me lirinë e medias	8
2.1.1. Progres-Raporti i vitit 2021 nga Komisioni Evropian për Shqipërinë	9
2.1.2. Raporti i vitit 2021 nga Departamenti Amerikan i Shtetit për Median	9
2.1.3. Raporti nga Freedom House 2021	10
2.1.4. Raporti nga Reporterët pa Kufij 2022	10
3. Paketa Anti-shpifje	12
3.1. Analizë e opinionit të Komisionit të Venecias	12
3.1.1. Reagimet e organizatave të brendshme dhe atyre ndërkombëtare mbi paketën anti-shpifje	15
4. Mbrojtja e gazetarëve në marrëdhëniet e punës	17
5. Gazetarët, si palë të paditura në procedurat gjyqësore	20
6. Etika në media	22
6.1. Nevoja për vetërregullimin e medias	25
6.1.1. Gjuha e urrejtjes	26
7. Rekomandimet	32

1. Hyrje

Liria e fjalës dhe e shprehjes së mendimit është një nga të drejtat më fundamentale të njeriut, mbi bazën e së cilës qëndron ofrimi i garancisë për lirinë e të shprehurit për çështje të caktuara dhe lirinë e aksesit në informacion. Mbrojtja dhe shkalla e garantimit të kësaj të drejte pasqyrojnë ekzistencën e vetë demokracisë. Kjo e drejtë mbrohet dhe garantohet me ligj, si një prej shtyllave kryesore të respektimit të të drejtave të njeriut. Në vetvete, liria e shprehjes përmban lirinë e shprehjes së mendimit dhe lirinë e shkëmbimit të informacioneve apo aksesit në informacione, të cilat mund të jenë me përmbajtje ekonomike, kulturore, sociale e veçanërisht politike lidhur me një shtet të caktuar. Promovimi dhe ofrimi i garancive në lirinë e shprehjes dhe lirinë e medias zhvillon mjedisin e kësaj të fundit, duke e bërë më të sigurtë, si dhe nxit pluralitetin e diversitetin mediatik.

Forcimi i shtetit të së drejtës në fushën e medias dhe lirisë së shprehjes, në Shqipëri, paraprihet nga sfida të pandalshme. Media dhe liria e shprehjes përfshihen nga dinamizmi i vazhdueshëm, dhe zhvillimi i vrullshëm. Republika e Shqipërisë është shtet palë dhe zbatuese e shumicës së instrumenteve ndërkombëtare të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Ndër këto instrumente mund të përmendim Paktin Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, si dhe Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut.

1.1. Zbatimi i standardeve ndërkombëtare në këtë fushë

Ekziston një kuadër ligjor i pasur i standardeve ndërkombëtare në fushën e lirisë së shprehjes duke nisur me parashikimet e nenit 10 të Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut, duke vazhduar me nenin 19 të Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, nenin 9 të Kartës Afrikane për të Drejtat e Njeriut, Rezolutën nr. 169 lidhur me Shfuqizimin e Ligjit për Shpifjen Penale në Afrikë nga Komisioni Afrikan për Njerëzimin dhe të Drejtat e Njeriut, nenin 10 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, nenin 10 të Konventës Amerikane për të Drejtat e Njeriut, si dhe së fundmi, Deklaratën Aziatike për të Drejtat e Njeriut¹. Emërues i përbashkët i gjithë këtyre garancive ndërkombëtare të ofruara është mbrojtja e të drejtës për t'u shprehur, për të ndarë informacion, si dhe për t'u informuar, pa patur ndërhyrjen arbitrare të shtetit apo të organeve të tij. Meqenëse është një nga të drejtat më themelore të njeriut, ndërhyrjet apo kufizimet që mund t'i bëhen kësaj të drejte duhet të jenë të ligjshme, sa herë

¹ Për një informacion më të zgjeruar lidhur me standardet ndërkombëtare në këtë fushë shih: https://en.unesco.org/sites/default/files/international_standards_on_freedom_of_expression_eng.pdf, lexuar së fundmi më 28.7.2022.

nevojitet për arsye të sigurisë kombëtare, për nevoja të shëndetit publik, në raste situatash të jashtëzakonshme dhe atëherë kur ky kufizim është domosdoshëm². Në kuadër të këtyre kufizimeve, shteti mund të detyrojë për mos-publikim tërësor të një informacioni apo vetëm të një pjese të tij, për ndërmarrje masash të natyrës disiplinore, për konfiskim të materialit që do të publikohej ose për evidentim të detyrueshëm të burimit të referuar në hartimin e materialit.

Ashtu si u përmend më lart, liria e medias parashikohet edhe në nenin 10 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, i cili nëpërmjet kësaj dispozite i ofron mbrojtje të palëkundur së drejtës për t'u shprehur³. Mbi bazën e nenit 10 të Konventës rregullohet e drejta për t'u shprehur lirisht për çështje me përmbajtje të shumëllojshme, liria e shtypit, si dhe rastet e veçanta të kufizimit të kësaj të drejte. Meqenëse e drejta për t'u shprehur lirisht është burim i mbrojtjes së një shtypi të lirë, atëherë është njëkohësisht edhe burim i mbrojtjes së gazetarëve.

Referuar angazhimeve konkrete të BE-së në këtë fushë ato janë parë me përparësi me qëllim forcimin e respektimit të së drejtës së shprehjes dhe mbrojtjen e pluralitetit mediatik. Edhe në Kartën e të Drejtave Themelore të BE-së, në nenin 11 të saj, bëhet i njëjti parashikim me nenin 10 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut lidhur me lirinë e shprehjes. Shpesh, Komisioni Evropian ka ndërmarrë nisma legjislative me në fokus mbrojtjen dhe ofrimin e një mjedisi të sigurtë e të qëndrueshëm gazetaresk⁴. Një rol mbështetës ka luajtur edhe Qendra Evropiane për Lirinë e Medias dhe të Shtypit, e cila ka zbatuar me efikasmeri disa projekte lidhur me evidentimin e shkeljeve të kryera ndaj kësaj të drejte dhe rastet e dhunimit të gazetarëve gjatë ushtrimit të detyrës së tyre në vendet candidate për t'u anëtarësuar në BE, por edhe në ato vende, të cilat janë tashmë anëtare të saj⁵.

Një ndër iniciativat më të fundit të Komisionit Evropian është edhe propozimi i realizuar nga ky i fundit, në kuadër të hartimit të një Direktive mbi Paditë Strategjike Kundër Pjesëmarrjes Publike, të njohura ndryshe si SLAPP⁶. Këto padi kanë si karakteristikë faktin se, janë një trajtë presioni e përdorur për gazetarë apo aktivistë të ndryshëm të mbrojtjes të të drejtave të njeriut

² Lidhur me përjashtimet nga rregulli i përgjithshëm i parashikuar në nenin 10 të Konventës Ndërkombëtare të të Drejtave të Njeriut shih: https://www.echr.coe.int/documents/guide_art_10_eng.pdf, lexuar së fundmi më 30.07.2022.

³ Lexo https://en.unesco.org/sites/default/files/international_standards_on_freedom_of_expression_eng.pdf, f. 8, lexuar së fundmi më 30.07.2022.

⁴ Referuar informacioneve lidhur me nismat legjislative të Komisionit Evropian në këtë aspekt lexo: <https://digital-strategy.ec.europa.eu/en/policies/media-freedom>, lexuar së fundmi më 30.07.2022.

⁵ Për më tepër detaje shih: <https://cmpf.eui.eu/media-pluralism-monitor/>, lexuar së fundmi më 30.07.2022.

⁶ Direktiva e Këshillit 2022/0177/EC, mbi mbrojtjen e personave të përfshirë në pjesëmarrjen e publikut nga proceset gjyqësore të padrejta ose qartazi abuzive, të njohura si “Paditë Strategjike kundër Pjesëmarrjes së Publikut”.

në mënyrë që, këta të fundit të mos shprehen për çështje me interes publik, pasi në të kundërt penalizohen⁷. Në Direktivë rekomandohen mekanizma efikasë dhe eficientë për çdo gjykatë, e cila do të marrë në shqyrtim raste të tilla, në mënyrë që të parandalohet zhvillimi i proceseve gjyqësore abuzive në çështje me palë gazetarë/mbrojtës të të drejtave të njeriut. Elementi karakterizues i Direktivës së propozuar është fusha e veprimit të saj, e cila shtrihet vetëm për çështje civile, tregtare apo ato me implikime ndërkufitare⁸.

1.2. Sfidat e vazhdueshme të lirisë së medias në Shqipëri

Ditët e sotme media në Shqipëri, përbëhet nga një përqendrim i theksuar politik, censurë dhe auto censure të lartë, keqinformim publik i gjerë, si dhe mungesa e verifikimit të burimeve të financimit të këtyre mediave. Sfidat e evidentuara në këtë fushë në kuadër të vetëcensurës së vënë ndaj gazetarëve, konflikteve të interesit mes pronarëve të mediave dhe pjesëtarëve të kabinetit qeveritar, sulmet e pandalshme ndaj gazetarëve të ndryshëm apo përfaqësuesve të medias etj, kanë bërë që, ky aspekt thelbësor i shtetit të së drejtës në Shqipëri, të haset me problematika të mëdha dhe me ndikime negative në disa sektorë⁹.

⁷ Për më tepër informacion lexo <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX:52022PC0177>, lexuar së fundmi më 01.08.2022.

⁸ Neni 2 i Direktivës lidhur me Paditë Strategjike kundër Pjesëmarrjes Publike.

⁹ Lexo për më tepër: https://crd.org/wp-content/uploads/2021/03/210222_PolicyPapers_ALB_FIN.pdf, lexuar së fundmi 01.08.2022.

2. Jurisprudenca e GJEDNJ

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut në praktikën e saj ka përcaktuar një sërë parimesh rregulluese të lirive të medias, duke iu referuar nenit 10 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

Censura është një ndër barrierat e vazhdueshme të gazetarisë. Pikërisht, lidhur me këtë aspekt GJEDNJ-ja është ndalur edhe në vitin 2021 me çështjen *Dareskizb Ltd v. Armenia*¹⁰. Kjo çështje lidhet me ndalimin nga qeveria armene të botimit të gazetës së quajtur “*Haykakan Time*”. Botimi nga kompania “*Haykakan Zhamanak*” të “*Haykakan Time*” u realizua gjatë një gjëndjeje të jashtëzakonshme të shkaktuar pas kryerjes të zgjedhjeve presidenciale në vitin 2008. Pas kalimit në një kalvar të gjatë gjykimesh, me shqyrtimin e çështjes nga GJEDNJ, ajo konstatoi se, kufizimi i publikimit të gazetës armene nuk kishte pasur qëllim tjetër përveçse të fshihte për publikun e gjerë kritikën ndaj qeverisë armene. Për më tepër Gjykata në vendimin e saj përfundimtar u shpreh se: “*Refuzimi i Gjykatës Administrative Armene për të dëgjuar çështjen e kompanisë ankuese, njëkohësisht botuese të artikullit, duke pretenduar çështje juridiksioni, i kishte mohuar në mënyrë specifike kësaj të fundit aksesin në gjykatë. Demokracia lulëzon në lirinë e shprehjes. Botimi i gazetës është penguar pavarësisht nga përmbajtja e rregullt e saj, pa patur të përfshirë në të gjuhë urrejtjeje ose nxitje trazirash. Kufizimet e vendosura ndaj kompanisë ankuese nuk janë legjitime dhe nuk janë të nevojshme në një shoqëri demokratike.*” Bazuar në argumentat e dhëna më sipër nga Gjykata u vendos se, në rastin konkret ka shkelje të nenit 10, i cili mbron lirinë e shprehjes, si dhe të nenit 6/1 të KEDNJ-së, i cili lidhet me të drejtën për një gjykim të drejtë.

Çështje tjetër e gjykuar nga GJEDNJ gjatë vitit 2021 është çështja *Biancardi v. Italy*¹¹. Kjo e fundit lidhet me kufizimin, që i bëhet botuesve online lidhur me një artikull të caktuar në të cilin shkelet e drejta e privatësisë së personit të përmendur në artikull. Në rastin konkret aplikanti ankues në GJEDNJ punonte si kryeredaktor i një gazete, e cila operonte online. Ai botoi një artikull, që përshkruante një përleshje në një restorant dhe procedimin penal që, pasoi me personat e përfshirë në këtë përleshje. Personi i përmendur në artikull kërkoi fshirjen e artikullit, por kjo gjë nuk ndodhi. Pas kalimit të çështjes në Gjykatë, Gjykatat Italiane vendosën se, duke mos e fshirë artikullin, botuesi e kishte bërë atë lehtësisht të aksesueshëm në internet

¹⁰ Për më tepër informacione shih: Çështja nr. 61737/08 *DARESKIZB LTD v. ARMENIA* <https://hudoc.echr.coe.int/fre#%7B%22itemid%22:%5B%22001-211813%22%7D>, lexuar së fundmi më 01.08.2022.

¹¹ Çështja nr. 77419/16 *Biancardi v. Italy* [2021] <https://hudoc.echr.coe.int/fre#%7B%22itemid%22:%5B%22001-213827%22%7D> lexuar së fundmi më 01.08.2022.

për një periudhë të konsiderueshme dhe kishte shkelur të drejtën e kërkuarit për jetë private të mbrojtur nga neni 8. Në këtë çështje GJEDNJ-ja e la në fuqi vendimin e Gjykatës së brendshme. GJEDNJ u shpreh se: *“Mbështesim dhënien e dëmit jopasuror nga kryeredaktori në drejtim të aplikantit ankues, duke marrë parasysh natyrën e ndjeshme të të dhënave personale të publikuara. Publikimi i informacionit plotësues ose sqarues, pas lançimit të artikullit do të ishte i pamjaftueshëm për të balancuar të drejtat e aplikantit sipas nenit 8 me të drejtat e botuesit sipas nenit 10. Duke mbajtur në konsideratë (i) kohëzgjatjen për të cilën artikulli u mbajt në internet, (ii) ndjeshmërinë e të dhënave në fjalë, si dhe (iii) peshën e sanksionit të vendosur ndaj aplikantit, justifikohet kufizimi i të drejtës lidhur me lirinë e shprehjes.”* Pra, në rastin në fjalë nuk kemi shkelje të së drejtës së parashikuar në nenin 10 të KEDNJ-së. Siç vihet re edhe në këtë vendim, shpesh çështjet referuar lirisë së shprehjes (neni 10), referojnë edhe tek e drejta për jetë private (neni 8). Ka interes analiza e bërë nga gjykata në mënyrë që, e drejta për të shpërndarë informacione të jetë në proporcion me të drejtën për respektimin e jetës private. Gjithmonë duhen mbajtur në konsideratë rrethanat në të cilat publikohen informacionet, të cilat referojnë në të dhënat sensitive të një individi të caktuar.

Çështja tjetër është Standard Verlagsgesellschaft mbH kundër Austrisë dhe lidhet me disa urdhra të Gjykatës së brendshme në sajë të një padie të bërë nga një kompani mediatike austriake për një kompani tjetër të tillë, në mënyrë që kjo e fundit të zbulonte informacionin e përdoruesve të regjistruar, të cilët kishin postuar komente në web-faqen e saj të internetit der Standard¹². Ky web-site dyshohej se, përmbante komentet lidhur me politikanë të ndryshëm, për çështje korrupsioni apo komente lidhur me neo-nazistë, të cilat kompania ankuese i kishte hequr, ndonëse refuzoi të zbulonte informacionet e komentuesve. Gjykata vendase konstatoi se, të dhënat e përdoruesve nuk gëzonin mbrojtjen e "burimeve gazetareske" dhe nuk kishte të drejtë absolute për anonimitetin në internet. GJEDNJ, për rastin në fjalë, u shpreh në vendimin e saj se: *“Komentet në fjalë nuk kishin as gjuhë urrejtjeje dhe as nxitje ndaj dhunës. I gjithë preteksti i kompanisë austriake, e cila ngriti padinë në gjykatën vendase, qëndronte në komentimin e dy politikanëve dhe një partie politike lidhur me një debat politik publik. Detyra e gjykatave vendase në këtë rast ishte të balanconin interesat konkurruese. Gjykatat vendase kishin dështuar t’u bënë në këtë, sidomos Gjykata e Lartë, duke mos dhënë asnjë arsye se, pse interesat e paditësve kishin peshuar më shumë se, ato të kompanisë ankuese për të ruajtur identitetin e përdoruesve të saj sekret. Gjykata vendase nuk kishte dhënë arsye të mjaftueshme*

¹² Për më tepër detaje të këtij vendimi lexo: Çështja nr. 39378/15 *Standard Verlagsgesellschaft mbH v. Austria* [2021] <https://hudoc.echr.coe.int/eng#%7B%22itemid%22:%5B%22002-13508%22%5D%7D>, lexuar së fundmi më 01.08.2022.

për të justifikuar ndërhyrjen në të drejtat e kompanisë ankuese. Për këtë arsye, urdhrat e gjykatës nuk ishin të nevojshme në një shoqëri demokratike, dhe patjetër që ka shkelje të nenit 10 të Konventës.”

2.1. Legjislacioni Shqiptar lidhur me lirinë e medias

Zbatimi i standardeve ndërkombëtare, standardeve të vendosura nga BE dhe studimi i raporteve vjetore të nxjerra në këtë fushë nga organizatat e shoqërisë civile, organizatat ndërkombëtare apo institucionet publike, i ka dhënë një shtytje të madhe zhvillimit të mëtejshëm të kuadrit ligjor dhe atij praktik të lirisë së medias në Shqipëri.

Legjislacioni shqiptar në këtë fushë është zhvilluar përgjatë disa viteve, nga palë të ndryshme interesi, duke përfshirë këtu qeverinë, organizatat e shoqërisë civile apo organizatat ndërkombëtare si: OSBE, Këshilli i Evropës dhe Bashkimi Evropian. Po në këtë plan, dispozitat legjislative e rregulluese të kuadrit ligjor shqiptar lidhur me lirinë në media dhe lirinë e shprehjes ofrojnë garanci dhe mbrojtje kushtetuese në këtë drejtim në nenet 22 dhe 23 të Kushtetutës, të cilat rregullojnë e lirinë e shprehjes, lirinë së shtypit, të radios, televizionit, dhe të drejtën për t'u informuar.

Në Shqipëri, përpos këtyre parashikimeve ligjore ekziston rregullim detajues i funksionimit të medias-audiovizive, por mungon një ligj për rregullimin e shtypit, pavarësisht se, mbrohet me ligj¹³. Kjo është një rrjedhë e thjeshtë logjike, pasi liria e shtypit kategorizohet në ato të drejta esenciale demokratike, e cila mund të ekzistojë edhe pa patur një rregullim legjislativ me një ligj të posaçëm. Shtypi është i lirë dhe liria e shtypit mbrohet me ligj. Në lirinë e shtypit është e ndaluar në mënyrë absolute censura dhe ecet drejt vetërregullimit të tij.

Referuar funksionimit të medias audiovizive ligji rregullues për këtë veprimtari, si dhe për shërbimet mbështetëse të medias audiovizive është ligji nr. 97/2013 “Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Autoriteti kompetent i parashikuar në ligj si rregullator i fushës së medias audiovizive është A.M.A apo i njohur ndryshe si Autoriteti i Medias Audiovizive. Ligji përcakton qartësisht misionin, objektivat, dhe funksionin e këtij autoriteti. Ky është një autoritet i pavarur, por për veprimtarinë e tij raporton përpara Kuvendit. Po ashtu, anëtarët e bordit të A.M.A zgjidhen nga Kuvendi për një mandat 5 vjeçar. Në këtë aspekt vihet në diskutim pavarësia e autoritetit dhe shtohet vëmendja tek influenca e

¹³ Ligji nr. 8239, datë 03.09.1997 “Për Shtypin”, i ndryshuar.

drejtpërdrejtë e politikës tek media. Në mënyrë paradoksale, ndërsa neni 7 i ligjit i referohet papajtueshmërisë dhe konfliktit të interesave për të mos përzgjedhur si anëtarë të A.M.A individë, të cilët kanë qenë të lidhur me politikën apo janë aktualisht, ligji në nenin 9 parashikon se, zgjidhen dhe mbikëqyren nga Kuvendi anëtarët e A.M.A. Një autoritet rregullues mediash, por i politizuar njëkohësisht, nuk lë hapësirë për garantim të drejtash dhe lirish themelore referuar lirisë së shprehjes dhe lirisë së medias.

2.1.1. Progres-Raporti i vitit 2021 nga Komisioni Evropian për Shqipërinë

Përgjatë raportimeve të kryera në vitin 2021 për Komisionin Evropian lidhur me lirinë e shprehjes nuk ka patur përmirësime, por vijim të rasteve të ushtrimit të dhunës verbale, fushatave shpifëse dhe akte të frikësimit ndaj gazetarëve¹⁴. Sipas këtij raporti rekomandohet thellësisht vetërregullimi për mediat online.

Nga ana tjetër, nuk ka patur progres në kuadër të ofrimit të garancive nga autoriteti rregullator audiovizual për pavarësi funksionale. Raporti shprehet me këmbëngulje në ofrimin e transparencës për publikun, si dhe garantimin e një mjedisi gazetaresk profesional, por edhe cilësor. Referuar opinionit të Komisionit të Venecias dhe duke mbajtur në konsideratë thirrjen e vazhdueshme të organizatave mediatike ndërkombëtare, si dhe ato të të drejtave të njeriut, ky raport vë në fokus problematikat dhe kritikën për ndryshimet, që qeveria dëshironte të realizonte në ligjin nr. 97/2013 “Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë”¹⁵. Kjo paketë, është vlerësuar si jo-demokratike dhe si çënuese e fjalës së lirë.

2.1.2. Raporti i vitit 2021 nga Departamenti Amerikan i Shtetit për Median

Sipas raportit për vitin 2021 të Departamenti Amerikan të Shtetit lidhur me lirinë e shprehjes, duke përfshirë anëtarët e shtypit dhe mediave të tjera, ky i fundit konstatoi se: *“Pati raportime se, qeveria, bizneset dhe grupet kriminale synonin të ndikonin në media në mënyra të papërshtatshme. Ka patur përpjekje për të ushtruar presion të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë politik dhe ekonomik mbi median, duke përfshirë kërcënimet dhe dhunën ndaj gazetarëve, që u përpoqën të hetonin krimin dhe korrupsionin. Pronarët e bizneseve i përdornin lirisht mediat e tyre për të fituar favore dhe për të promovuar interesat e tyre me partitë politike. Gazetarët shpesh praktikojnë vetëcensurë për të shmangur dhunën dhe ngacmimet.”* Ky raport vë në pah

¹⁴ Citim nga Raporti, shih https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/albania-report-2021_en, f. 7, lexuar së fundmi më 01.08.2022.

¹⁵ Gjendet po aty.

edhe njëherë presionin e vazhdueshëm politiko-kriminal në media duke çuar drejtëpërdrejtë në praktikim të censurës apo vetëcensurës¹⁶. Sulmet e shpeshta verbale/fizike, si dhe presioni ngacmues ndaj gazetarëve gjatë ushtrimit të detyrës së tyre kanë përkeqësuar situatën duke mos patur asnjë lloj progresi në këtë fushë kaq thelbësore të të drejtave të njeriut dhe po ashtu, kanë rritur tensionin mes medias dhe politikës. “Trekëndëshi Media-Politika-Gjyqësori” duket se vazhdojnë të ndërlidhur me njëri-tjetrin në mënyrë të pazgjidhshme, edhe pse sot flasim për pavarësi të këtyre pushteteve, si parakusht të demokracisë së zhvilluar e funksionale. Referuar aspektit politik raporti shprehet se: *“Para zgjedhjeve parlamentare të prillit, organet e medias dhe shoqatat e gazetarëve u ankuan për mungesën e aksesit të pavarur të medias në ngjarjet e fushatës të mbajtura nga partitë politike, të cilat preferuan t’u ofrojnë mediave përmbajtjen e tyre të redaktuar nga partia.”* Sa i përket gjyqësorit, raporti konstaton se, shumë prej çështjeve të nisura nëpërmjet procedurave gjyqësore pushohen dhe mbeten pa zgjidhje.

2.1.3. Raporti nga Freedom House 2021

Sipas raportit vjetor për vitin 2021 nga “Freedom House” u konkludua se, ndërhyrja e biznesit dhe e politikës në sektorin e medias cenon pavarësinë e organeve të medias dhe të përfaqësuesve të këtyre të fundit¹⁷. Sipas këtij raporti, pasiguria përgjatë ushtrimit të punës, përballja e tyre me sulme/kërcënime, ngritja e padive ndaj tyre për veprën penale të shpifjes, e ka vështirësuar tej mase punën profesionale të gazetarëve.

2.1.4. Raporti nga Reporterët pa Kufij 2022

Sipas organizatës “Reporterët pa Kufij”, gjendja e sektorit mediatik edhe për vitin 2022 mbetet e përkeqësuar, duke shënuar rënie të respektimit të kësaj të drejte¹⁸. Gjatë publikimit të raportit u konkludua se, liria mediatike po rriskohet nga ndërhyrja masive në pavarësinë e medias, sulmet e shtuara ndaj gazetarëve apo përfaqësuesve të medias, të cilët merren kryesisht me lajmet e kronikës së zezë, si dhe dështimi i shtetit në gjetjen e mekanizmave adekuate për t’i mbrojtur punonjësit e shtypit. Sipas raportit të këtij viti, Shqipëria renditet në vendin nr. 103 nga 180 vende të botës. Duke bërë një krahasim me raportin e vitit 2021, vërehet një rënie e

¹⁶ Për më tepër detaje nga ky Raport lexo Raportin për të Drejtat e Njeriut 2021-Shqipëria <https://al.usembassy.gov/sq/our-relationship-sq/official-reports-sq/>, f. 8-10, lexuar së fundmi më 02.08.2022.

¹⁷ Lidhur me raportin nga Freedom House shih: <https://freedomhouse.org/country/albania/freedom-world/2022>, lexuar më 02.08.2022.

¹⁸ Për më tepër informacion nga ky raport lexo: <https://www.dw.com/sq/reporter%C3%ABt-pa-kufij-n%C3%AB-shqip%C3%ABri-integriteti-i-medias-rrezikohet-nga-krimi/a-61673206>, lexuar më 03.08.2022.

dukshme e në përkeqësim të sektorit të medias në Shqipëri, pasi gjatë vitit 2021 Shqipëria renditej në vendin nr. 83¹⁹.

¹⁹ Gjendet po aty.

3. Paketa Anti-shpifje

3.1. Analizë e opinionit të Komisionit të Venecias

Paketa anti-shpifje është një ndër paketat më të kritikuar nga aktorët ndërkombëtarë si: BE-ja, Parlamenti Evropian, Komisioni Evropian, Këshilli i Evropës, OSBE, organizatat e tjera ndërkombëtare për lirinë e medias, Presidenti i Republikës së Shqipërisë dhe Organizatat e Shoqërisë Civile.

Miratimi nga parlamenti shqiptar më 18 dhjetor 2019 i projekt-amendamenteve në ligjin nr. 97/2013 “Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjin nr. 9918/2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, si pjesë e paketës antishpifje, do të ishte zanafilla e një debati politiko-ligjor mes qeverisë nga njëra anë dhe organizatave ndërkombëtare, ekspertëve vendas, si dhe shoqërisë civile nga ana tjetër. Me vendosjen e vetos nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë, si shkak i rënies në kundërshtim të këtyre projekt-ndryshimeve me rendin demokratik dhe si dispozita cenuese të lirisë së shprehjes, Komisioni i Venecias përgatit në 20 Qershor 2019 një analizë të detajuar lidhur me këto projekt-amendamente, duke u fokusuar kryesisht tek ligji nr. 97/2013 “Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë”²⁰. Qëllimi kryesor i paketës-antishpifje do të lidhej me rregullimin e fushës së veprimtarisë së ofruesve të shërbimeve të publikuara elektronikisht, pra media online. Ndër arsyet e renditura për nevojën e miratimit të këtyre projekt-amendimeve përsihej aktiviteti i gjerë i medias online, publikimi i shumë informacioneve të pavërteta dhe nevoja për parandalim të publikimeve mashtruese për publikun e gjerë. Ndryshimet kryesore që do të pasqyroheshin në ligj lidheshin me:

1. Rregullimi ligjor i fushës së veprimtarisë së mediave online dhe operuesve të tyre
2. Shtirja e kompetencave të A.M.A dhe Komisionit të Ankesave edhe për organet e medias online
3. Të parashikohej e drejta për korrigjim ose dhënie përgjigjeje lidhur me publikimet online
4. Ndërmarrja e sanksioneve administrative apo e gjobave për shkelësit e ligjit

²⁰ Për t’u njohur më shumë me analizën e Komisionit të Venecias dhe rekomandimeve të realizuara në këtë kuadër shih: [https://www.venice.coe.int/webforms/documents/?pdf=CDL-AD\(2021\)053-e](https://www.venice.coe.int/webforms/documents/?pdf=CDL-AD(2021)053-e), lexuar më 03.08.2022.

Referuar pikës së parë, Komisioni rekomandoi parashikimin e një përkufizimi shterues dhe të mirë-përcaktuar lidhur me nocionin “publikime elektronike”²¹. Po ashtu, krahas këtij përkufizimi rekomandohej të parashikohej një dispozitë në ligj, e cila të tregonte qartë fushat për të cilat ky ligj nuk zbatohet. Ky arsyetim vjen si një rrjedhojë e logjikës së thjeshtë të faktit se, publikues elektronik mund të jenë edhe blogerët e vegjël ose individual apo personat, të cilët realizojnë publikime të tyre personale në media sociale.

Sa i përket kompetencave të A.M.A, këto të fundit me miratimin e projekt-amendamenteve merrnin një shtrirje edhe më të gjerë. Përveçse në rolin e monitoruesit të zbatimit të drejtë të ligjit nga subjektet e tij, autoriteti do të kishte kompetenca bashkë me Komisionin e Ankesave, për vendosjen e sanksioneve në rast se, subjekti kryente veprime apo mos-veprime, të cilat binin ndesh me ligjin. A.M.A do të kthehej në një organ ku do të mund të apelohehin vendimet e marra nga Komisioni i Ankesave lidhur me ankesat e shqyrtuara²². Shtrirja e funksionimit të A.M.A dhe Komisionit të Ankesave si “quasi-gjykata”, do të ishte tejet problematike, pasi në pikëpyetje profesionalizmin juridik, përvojën e gjerë në drejtësi dhe kualifikimin e duhur të këtyre organeve, në krahasim me atë të një gjyqtari të mirëfilltë. Përpos këtij shkak, sipas Komisionit u theksua se, ekziston një perceptim i gjerë se, A.M.A dhe Komisioni i Ankesave nuk respektojnë parimin e pavarësisë si organe, pavarësisht se, ligji e parashikon që në hyrje të tij një parim të tillë. Problematik mbetet fakti i përbërjes së A.M.A, anëtarët e së cilës zgjidhen nga përfaqësues të politikës. Akoma më problematik ishte aspekti i përzgjedhjes së anëtarëve të Komisionit të Ankesave nga A.M.A, si dhe miratimi i rregullave nga kjo e fundit për përzgjedhjen e këtij Komisioni. Në këtë kontekst, përkatësia e dukshme dhe e qartë politike e A.M.A, bie ndesh me nenin 7 të ligjit nr 97/2013 “Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i cili i referohet papajtueshmërisë dhe konfliktit të interesave. Ndërlidhja e këtyre organeve kryesore me miratimin e projekt-amendamenteve, u pa si tejet problematike dhe shkelte zbatimin e një parimi themelor kushtetues, që është pavarësia.

Së treti, parashikimi në ligj i të drejtës për korrigjim të informacionit të publikuar, kur ky i fundit mban të dhëna të pasakta apo kthimi i një përgjigjeje në një kohë sa më të arsyeshme lidhur me një informacion të publikuar, janë elementë të përfshirë në lirinë e shprehjes. Sipas opinionit të Komisionit, aspekti i së drejtës për të kthyer një përgjigje i referohet vetëm rasteve

²¹ Lexo për më tepër [https://www.venice.coe.int/webforms/documents/?pdf=CDL-AD\(2021\)053-e](https://www.venice.coe.int/webforms/documents/?pdf=CDL-AD(2021)053-e) , f. 8, lexuar më 03.08.2022.

²² Lexo citimin nga Opinioni i Komisionit të Venecias për më tepër detaje lidhur me këtë pikë [https://www.venice.coe.int/webforms/documents/?pdf=CDL-AD\(2021\)053-e](https://www.venice.coe.int/webforms/documents/?pdf=CDL-AD(2021)053-e) , f. 10, lexuar më 04.08.2022.

kur publikohen informacione të rreme ose kur ceket pa të drejtë personaliteti i një individi dhe jo kur ka kritika ndaj informacionit të publikuar nga ofruesi i shërbimit të publikimit elektronik²³. Krahas parashikimit të kësaj të drejte do të ishte mirë të parashikoheshin dhe rastet e kufizimit të saj për të patur të qartë shtrirjen apo limitin e kësaj të drejte.

Së katërtri, mos-zbatimi i parashikimeve ligjore bën pjesë në procedurat e ankimit administrativ. Apelimi i vendimit të marrë nga Komisioni i Ankesave, pas shqyrtimit të ankesës, i cili zakonisht konsiston në marrjen e një mase, përfshirë këtu edhe sanksione, mund të realizohet drejtpërdrejtë nga A.M.A, e cili shërben si shkallë apelimi²⁴. Vendimet e marra nga A.M.A mund të ankimoheshin në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë dhe nuk parashikohej apelimi i çështjes në një gjykatë më të lartë. Komisioni theksoi që, një problematikë tjetër në këtë aspekt është se, referimi i këtyre ankesave në drejtim të ofruesve të shërbimeve të publikuara elektronikisht, bën edhe më të vështirë lidhjen e përgjegjësisë administrative, përgjegjësisë civile dhe asaj penale. Sa i përket gjobës, si një ndër masat që mund të vendoset nga Komisioni i Ankesave apo A.M.A, mbeten të paqarta kriteret mbi bazën e së cilave merrej ajo. Po ashtu, gjobat e vendosura nga Komisioni i Ankesave, pavarësisht ankimimit të tyre, nuk pezullonin zbatimin e vendimit, pasi vendimet administrative kanë efekt ekzekutiv.

Edhe pse një paketë e miratuar me disa verisone, ajo sërisht u nënvizua nga ekspertët ndërkombëtarë e vendas, shoqatat e medias, si dhe OJQ-të si cenuese e lirisë së shprehjes dhe me impakte negative në këtë fushë. Të njëjtin opinion ndau dhe Komisioni i Venecias duke e lënë këtë paketë të pamiruar në totalin e saj. Mungesa e pavarësisë së A.M.A dhe Komisionit të Ankesave, paqartësia ligjore lidhur me një sërë dispozitash, mos-ofrimi i garancive të duhura procedurale referuar procedurave të ankimit, si dhe vendosja e gjobave në mënyrë jo-proporcionale, bënë që Komisioni me këtë analizë të kundërshtonte miratimin e kësaj pakete. Sipas rekomandimeve të Komisionit sfidat e mëdha me të cilat ndeshet media online në Shqipëri mund të mbështeten përmes ngritjes së mekanizmave eficientë, siç është ngritja dhe implementimi i një organi vetërregullues dhe të pavarur, ku në krye të të cilit të qëndrojnë përfaqësues të komunitetit të medias. Kjo do të ishte një mënyrë tejet efikase për të rritur besimin në publikun e gjerë, për pavarësinë e medias.

²³ Shih për më shumë [https://www.venice.coe.int/webforms/documents/?pdf=CDL-AD\(2021\)053-e](https://www.venice.coe.int/webforms/documents/?pdf=CDL-AD(2021)053-e), f. 13, lexuar më 04.08.2022.

²⁴ Për këtë pikë shih [https://www.venice.coe.int/webforms/documents/?pdf=CDL-AD\(2021\)053-e](https://www.venice.coe.int/webforms/documents/?pdf=CDL-AD(2021)053-e), f. 14, lexuar më 04.08.2022.

3.1.1. Reagimet e organizatave të brendshme dhe atyre ndërkombëtare mbi paketën anti-shpifje

Lidhur me paketën anti-shpifje, edhe Unioni i Gazetarëve Shqiptarë së bashku me mbi 16 organizata të tjera gazetarësh, ndër të cilat kryesonin organizatat e shoqërisë civile reagues publikisht përmes një deklaratë duke shprehur insistimin e vazhdueshëm që, kjo paketë “anti-kushtetuese” të mos miratohej²⁵.

Sipas raportit vjetor nga RFS, nga axhenda politike ende nuk është hequr qartazi e ashtuquajtura paketë anti-shpifje, që do t'i jepte shtetit pushtet disproporcional mbi përmbajtjen e mediave online dhe do të përforconte autocensurën, ndonëse versioni i saj fillestar është kritikuar nga Këshilli i Evropës, Bashkimi Evropian dhe nga organizatat ndërkombëtare për lirinë e shtypit²⁶.

Për më tepër, edhe sipas raportit për vitin 2021, të nxjerrë nga D.A.SH, paketa anti-shpifje i lejon palët private të paraqesin kërkesa për kompensim financiar lidhur me fyerje ose publikim të qëllimshëm të informacionit shpifës. OJQ-të deklaruan se, gjobat ishin të tepërta dhe mund të varionin të alternuara edhe me një dënim penal, duke çuar në minim total të lirisë së shprehjes²⁷.

Në të njëjtën linjë, edhe Përfaqësuesi i OSBE-së për Lirinë e Medias, z. Harlem Desir u shpreh kundër miratimit të projekt-amendamenteve dhe nënvizoi nevojën e madhe për përmirësim²⁸. Sipas tij, parashikimi në këto projekt-amendamente pjesë e paketës anti-shpifje, përpos të tjerave se, nevojitet regjistrim i detyrueshëm për mediat, të cilat operojnë online, pranë Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) mund të sillte një efekt shumë negativ në lirinë e medias.

Nga ana tjetër Federata Evropiane dhe ajo Ndërkombëtare e Gazetarëve shprehën mbështetjen e tyre për deklaratat e Shoqatës “Gazetarët Profesionistë të Shqipërisë”, të cilët shprehnin refuzimin e këtyre miratimeve, duke i parë ato si kërcënuese të mjedisit mediatic. Një deklaratë

²⁵ Për më tepër detaje rreth deklaratës së Unionit të Gazetarëve Shqiptarë referuar paketës anti-shpifje shih: <https://unionigazetarëve.com/index.php/2020/09/23/nje-tjeter-apel-i-rendesishem-per-terheqjen-e-paketes-antishpifje-nga-parlamenti/>, lexuar më 04.08.2022.

²⁶ Për detaje të mëtejshme mbi raportin shih: <https://www.dw.com/sq/reporter%C3%ABt-pa-kufij-n%C3%AB-shqip%C3%ABri-integriteti-i-medias-rrezikohet-nga-krimi/a-61673206>, lexuar së fundmi më 05.08.2022.

²⁷ Lexo <https://al.usembassy.gov/sq/our-relationship-sq/official-reports-sq/>, lexuar së fundmi më 05.08.2022.

²⁸ Shih për më shumë <https://balkaninsight.com/2018/10/19/albania-website-registration-request-criticized-10-18-2018/>, lexuar së fundmi më 05.08.2022.

u lëshua gjithashtu nga Federazione Nazionale della Stampa Italiana ku kërkohej ndërhyrja e BE-së dhe e qeverisë italiane²⁹.

Një organizatë tjetër, me një veprimtari të shtrirë në mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të njeriut “Civil Rights Defenders”, në një deklaratë të përbashkët, që u mbështet nga 14 organizata të tjera të shoqërisë civile shqiptare, u shpreh se: *“Këto projektligje, në një mënyrë të paprecedentë në vendet demokratike, synojnë të vendosin një regjim kontrolli administrativ në median online. Ato rrezikojnë rritjen e censurës dhe autocensurës në median vendase dhe mund të kontribuojnë në pengesat e mëtejshme të lirisë së medias dhe lirisë së shprehjes në Shqipëri, e cila po përkeqësohet”*³⁰.

Të njëjtin qëndrim kritik kanë mbajtur edhe Qendra Evropiane për Lirinë e Shtypit dhe Medias, Federata Evropiane e Gazetarëve, Instituti Ndërkombëtar i Shtypit, Komisionerja e Këshillit të Evropës për të Drejtat e Njeriut duke nënvizuar faktin se, këto propozime lidhur me projektligjet si pjesë të paketës anti-shpifje nuk janë në përputhje me praktikën më të mira për vetërregullimin dhe do të kishin një ndikim negativ në lirinë e shprehjes në Shqipëri³¹. Në vijim të kryesimit të OSBE-së nga Shqipëria përgjatë vitit 2020 dhe në kuadër të përmbushjes së disa detyrave thelbësore për ofrimin e cilësisë dhe sigurisë në sektorin mediatik, u pa si problematikë nga organizatat dhe institucionet e mësipërme marrja e Presidencës së OSBE-së nga Shqipëria gjatë vitit 2020. Gjithashtu, mungesa e pasqyrimin të jurisprudencës nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut së bashku me standardet e Këshillit të Evropës në këto projekt-amendamente të diskutuara gjerësisht ishte tejet problematike për situatën në atë periudhë³². Pa-përputhshmëria me standardet evropiane në këto projekt-amendamente linte për të dëshiruar!

²⁹ Lexo për më shumë <https://www.institutemedia.org/2020/01/11/international-and-albanian-media-freedom-organizations-strongly-criticize-the-two-draft-laws-on-online-media/>, lexuar së fundmi më 05.08.2022.

³⁰ Për më tepër vizito: <https://crd.org/2019/12/10/media-freedoms-in-albania-must-be-protected/>, lexuar së fundmi më 05.08.2022.

³¹ Lexo për më tepër në këtë drejtim: <https://www.institutemedia.org/2020/01/11/international-and-albanian-media-freedom-organizations-strongly-criticize-the-two-draft-laws-on-online-media/>, lexuar së fundmi më 05.08.2022.

³² Lidhur me qëndrimet referuar miratimit të paketës anti-shpifje lexo: <https://exit.al/en/2020/04/21/coe-commissioner-dunja-mijatovic-notes-issues-with-human-rights-in-member-states/>, lexuar së fundmi më 05.08.2022.

4. Mbrojtja e gazetarëve në marrëdhëniet e punës

Gazetarët mund t'i konsiderojmë sot si një prej lobuesve më të rëndësishëm të mbrojtjes të të drejtave të njeriut, duke evidentuar me transparencë të plotë çdo situatë ku shkelen apo dhunohen të drejtat e njeriut dhe duke informuar publikun e gjerë për këto raste. Sipas një raporti studimor të realizuar nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit në vitin 2020 rreth të drejtave të punës së gazetarëve, u vunë në pah disa problematika serioze në këtë aspekt, të renditura si më poshtë³³:

- a) Mungesa e nënshkrimit të kontratës së punës apo mos-zbatimi i duhur i kontratave, duke i shkelur ato
- b) Probleme të vazhdueshme me shpërblimet
- c) Të punuarit padrejtësisht në kushte jo të mira pune
- d) Largime abuzive nga puna
- e) Mungesa e sigurisë në punë përgjatë kryerjes së detyrave profesionale

Në adresim të çështjes së mungesës së kontratave, rreth 16.67% e gazetarëve të intervistuar pohuan se, nuk kanë nënshkruar një kontratë pune për median apo portalin për të cilin punojnë, ndërsa 13.33% rikonfirmuan se, është i vërtetë fakti i mungesës së këtyre kontratave, por jo kudo³⁴. Ky aspekt nuk përbën problem për mediat e mëdha televizive apo portalet me shtrirje të gjerë, por për ato me njohje dhe shtrirje të vogla, të cilat nuk e shohin të nevojshme formalizimin e marrëdhënies së punës me punëmarrësin. Me nënshkrimin e kësaj kontrate punëmarrësit, i cili në rastin konkret është gazetar, i bëhen të ditura informacione rreth kushteve të punës, elementë të rëndësishëm të marrëdhënies së punës dhe është shumë më i mbrojtur juridikisht nga largimet e padrejta apo abuzive nga pronarët e mëdhenj të mediave, të cilët kanë tendencë për t'i shfrytëzuar këta të fundit. Edhe në rastet kur këto kontrata nënshkruhen dhe formalizohet disi sektori i medias, serish vihet re një keq-hartim i këtyre kontratave nga “pala më e fuqishme”. Zakonisht këto kontrata janë kthyer në kontrata Ad’hezioni, ku “më i fuqishmi”, pra në këtë rast pronari i medias ku do të punojë punëmarrësi, harton paraprakisht të gjitha kushtet e kontratës dhe gazetarit/përfaqësuesit të medias nuk i mbetet gjë tjetër veçse të pranojë ose jo formalizimin e marrëdhënies së punës. Ajo që vihet re më së shumti në

³³ Për më tepër të dhëna shih: https://ahc.org.al/wp-content/uploads/2020/06/Raport-Studimor_Te-drejta-pune-per-gazetaret_ALB-1.pdf, f. 25, lexuar së fundmi më 05.08.2022.

³⁴ Referuar çështjes së mungesës së kontratave shih: https://ahc.org.al/wp-content/uploads/2020/06/Raport-Studimor_Te-drejta-pune-per-gazetaret_ALB-1.pdf, f. 27-28, lexuar së fundmi më 06.08.2022.

hartimin e këtyre kontratave dis-favorizuese për “palën më të dobët” janë parashikimi i dispozitave, të cilat referojnë tek ndalimi i konkurrencës.

Referuar pjesës së shpërblimit, ky studim ka konkluduar se, rreth 10% e gazetarëve të intervistuar pohojnë për vonesa 5 ditore në rrogë, nga data e përcaktuar në kontratën e punës për të marrë shpërblimin për punën e kryer³⁵. Pavarësisht këtij pohimi për vonesat e vazhdueshme në paga rreth 53.33% e të intervistuarve deklaruan se, nuk ka vonesa në paga dhe se, ato jepen në kohën e përcaktuar në kontratë. Gjithsesi ky problem duket se është zbehur në sektorin e mediave të mëdha. Problem tjetër i lidhur me aspektin financiar është mungesa e dhënies së shpërblimit për punët e kryera përtej orarit zyrtar të punës. Përgjatë këtij studimi të kryer rreth 46.67% e gazetarëve të intervistuar pohuan se, orari i punës i kalon 40 orë në javë, ndërsa 10% e tyre thanë se ky orar respektohet³⁶. Duke qenë se, profesioni i përfaqësuesve të medias ka një ekspozim të pakufizuar kohor ndaj informacionit, kuptohet që, edhe puna e tyre kërkon impenjim përtej orarit të përcaktuar për mbylljen e saj, por kjo nuk justifikon mos-shpërblimin e gazetarëve për punën e realizuar. Po ashtu, mos-deklarimi i rrogës së plotë në bankë, është konfirmuar nga 23.33% e të intervistuarve, ndërsa 43% e tyre e mohuan një fakt të tillë pasi rroga iu kalonte e plotë në bankë. Sipas gazetarëve, ata konfirmojnë se, janë të vetëdijshëm për këtë informalitet, por nuk kanë mundësi kundërshtimi, si një mënyrë e vetme për të mbajtur vendin e punës. Referuar pagimit nga ana e punëdhënesit të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, rreth 23% e gazetarëve pohojnë se, punëdhënesit nuk i paguajnë sigurimet e tyre shoqërore dhe shëndetësore, ndërsa rreth 46.7% e të intervistuarve shprehen se iu paguhen sigurimet.

Në adresim të nevojës për të patur kushte të drejta pune, nga të intervistuarit lidhur me lejet javore është deklaruar se, rreth 43.3% e tyre nuk e kanë pushim ditën e diele, ndërsa 13.3% e tyre e gëzojnë këtë të drejtë³⁷. Pavarësisht se, sektori mediatik bën përjashtim nga rregulli ku pushimi javor duhet të ketë të dielën pushim, duhen mbajtur në konsideratë gjithnjë parashikimet e VKM-së nr. 358 datë 25.03.1996 “Për rregullimin e kohës së punës dhe të pushimit në shtypin e folur dhe të shkruar”. Po ashtu, gjuha fyese e përdorur ndaj gazetarëve, si dhe tejkalimi i kufijve të etikës nga eprorët e tyre përgjatë orarit zyrtar të punës kanë bërë që

³⁵ Referuar çështjes së shpërblimit shih: https://ahc.org.al/wp-content/uploads/2020/06/Raport-Studimor_Te-drejta-pune-per-gazetaret_ALB-1.pdf, f. 29-35, lexuar së fundmi më 06.08.2022.

³⁶ Gjendet po aty.

³⁷ Për më tepër informacion lidhur me çështjen e respektimit të kushteve të punës shih: https://ahc.org.al/wp-content/uploads/2020/06/Raport-Studimor_Te-drejta-pune-per-gazetaret_ALB-1.pdf, f. 36-41, lexuar së fundmi më 06.08.2022.

23.33% e të intervistuarve t'a pohojnë një fakt të tillë, në kundërshtim me 36.67% të gazetarëve, të cilët deklarojnë se, iu respektohet dinjiteti dhe të drejtat në punë. Po në të njëjtën linjë ecet me diskriminimet si shkak i përkatësisë, gjinisë, moshës, bindjeve politike apo orientimit seksual. Edhe çështjet lidhur me ngacmimin seksual në vendin e punës mbeten në shumicën e rasteve të pa-adresuara si shkak i presionit të eprorëve apo si shkak i paragjyqimeve të shumta, të cilat mund të lindin në ambientet e punës, nga kolegët e punës. Lidhur me kushtet e drejta të punës nën aspektin e kapaciteteve teknike dhe ofrimit të komoditetit ndaj gazetarit përgjatë ushtrimit të detyrës profesionale, vihet re se, ka një disbalancë mes mediave, varësisht madhësisë dhe fuqisë së tyre. Mos-pasja e pajisjeve të punës, si dhe ambientet e papërshtatshme të zhvillimit të detyrave profesionale, kërkojnë vëmendje të shtuar qoftë nga organizatat mediatike të brendshme, por edhe nga OJQ-të me interes në këtë fushë.

Sa i përket largimeve abuzive nga puna, këto të fundit vazhdojnë në mënyrë të përhershme thuajse në çdo media të madhe apo të vogël, duke e bërë këtë largim jo-legjitim. Në përgjithësi këto largime vijnë si shkak i marrëdhënieve të përkeqësuar mes gazetarit dhe eprorit, ku ky i fundit tenton të shfrytëzojë punën e gazetarit, pavarësisht se, ndërmjet tyre mund të ketë ose jo një kontratë të nënshkruar³⁸.

Rreth aspektit të sigurisë në punë është vënë re një shtim i rasteve ku evidentohen kërcënime të vazhdueshme të gazetarëve dhe mbrojtje e vakët nga redaksitë ku punojnë ose në rastin më të mirë nuk mbrohen aspak³⁹. Duke mbajtur në konsideratë karakteristikat e këtij profesioni, i cili është tej mase i ekspozuar ndaj risqeve të ndryshme, risqe të cilat “bien mbi kurriz” të gazetarëve, këta të fundit sulmohen fizikisht/verbalisht, kërcënohen ose fyhen, duke e bërë kështu të pamundur kryerjen e punës së tyre dhe duke nxitur tek ata ndjenjën e frikës.

³⁸ Rreth largimeve abuzive nga puna lexo: <https://ahc.org.al/wp-content/uploads/2020/06/Raport-Studimor-Te-drejta-pune-per-gazetaret-ALB-1.pdf>, f. 42-44, lexuar së fundmi më 06.08.2022.

³⁹ Për më tepër detaje të këtij raporti për pjesën e sigurisë në punë shih: <https://ahc.org.al/wp-content/uploads/2020/06/Raport-Studimor-Te-drejta-pune-per-gazetaret-ALB-1.pdf>, f. 45, lexuar së fundmi më 06.08.2022.

5. Gazetarët, si palë të paditura në procedurat gjyqësore

Rrjeti i gazetarëve në ditët e sotme përballet me sfida të shumta, sidomos si shkak i kritikave dhe presionit të madh, që haset në organizatat mediatike. Sulmet fizike, ushtrimi i presionit, ofendimet, gjuha denigruese, realizimi i proceseve të padrejta gjyqësore, si dhe gjuha e urrejtjes e përdorur ndaj tyre, kanë qenë dhe janë në fokus të organizatave të shoqërisë civile, por edhe të atyre me karakter ndërkombëtar. Kjo dukuri negative ka çuar në shfaqjen e vetëcensurimit si pasojë e presionit të madh të ushtruar dhe frikës së ngritjes së padive civile/penale ndaj tyre. Dispozita e vetme ligjore në legjislacionin shqiptar, ku shprehet indirekt mbrojtja e akorduar ndaj gazetarëve në rastet e kërcënimeve apo sulmeve fizike është neni 261 i Kodit Penal, ku për këto shkelje parashikohet si sanksion vendosje gjobe apo burgim me 3 vjet. Pavarësisht këtij parashikimi ligjor, sipas Raportit të përcjellë nga Komisioni Evropian për vitin 2020, praktikisht janë shumë të pakta rastet e raportimeve të këtyre sulmeve ndaj gazetarëve në autoritetet kompetente. Nga ana tjetër sipas Raportit të Komisionit Evropian për vitin 2021, duke e krahasuar me Raportin e vitit 2020 referuar lirisë së shprehjes dhe të medias, situata në këtë fushë mbetet e njëjtë dhe pa ndonjë përmirësim të dukshëm.

Si shkak i sulmeve të vazhdueshme verbale/fizike ndaj gazetarëve, sidomos të gazetarëve të cilët ushtrojnë profesionin me kronikat e zeza dhe janë pjesën më të madhe të kohës të pranishëm në terren, janë rritur edhe tentativat e tyre për të ngritur padi pranë gjykatave. Serish, presioni i largimit nga puna nga ana e eprorit mbetet një ndër elementet më të rëndësishme dhe njëkohësisht barrierë për të ngritur padi të tilla edhe pse këto të fundit janë tërësisht legjitime. Sipas Barometrit Kombëtar të realizuar përgjatë vitit 2021 nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit lidhur me Lirinë në Media, gjatë një anketimi referuar aksesit në gjykatë nga ana e gazetarëve është konkluduar se, 64% e rasteve kur gazetarët dëshirojnë të ngrenë padi, por nuk e bëjnë një gjë të tillë vjen si shkak i formaliteteve, ndërsa 54.4% të rasteve nuk ngrihet padi si shkak i shkarkimit nga puna nga punëdhënësi⁴⁰. Nga ana tjetër 44% e rasteve janë stepur si shkak i mos-punësimit në punëdhënës të tjerë, pasi këta të fundit në raste të tilla, ndajnë mendime të përbashkëta⁴¹. Po ashtu, përgjatë punimit për Barometrin Kombëtar lidhur me Lirinë e Medias, janë kërkuar informacione të detajuara lidhur me proceset gjyqësore me palë gazetarë në gjykatat e rretheve gjyqësore të vendit. Sipas informacioneve të dhëna rreth 18 gjykata kanë

⁴⁰ Lidhur me anketimin e realizuar nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit në Barometrin Kombëtar lidhur me Lirinë e Medias për vitin 2021 dhe për më tepër detaje rreth aksesit në gjykata nga gazetarët lexo: <https://ahc.org.al/wp-content/uploads/2021/10/Barometri-Kombetar-per-Lirine-e-Media-2020.pdf>, f. 27.

⁴¹ Gjendet po aty.

kthyer përgjigje, nga 23 në total, si dhe vetëm 10 prej këtyre 18 gjykatash kanë deklaruar se, përgjatë periudhës Janar-Dhjetor 2020 nuk ka pasur çështje gjyqësore dhe nuk janë dhënë vendime me padi ku subjekte kanë qenë palë përfaqësues të medias apo gazetarë⁴². Në gjykatën e Korçës ekzistonte në proces një çështje për veprën penale “Ndërhyrje të Padrejta në Jetën Private”, ndërsa në Gjykatën e Fierit janë regjistruar 3 çështje, ku njëra është e natyrës civile dhe 2 të tjerat me natyrë penale. Nga ana tjetër, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Krujë rezultojnë të ketë pasur në këtë periudhë 1 çështje penale, por të pushuar lidhur me veprën penale të “Fyerjes së Gjyqtarit ose Prokurorit”. Po ashtu, në Gjykatën e Gjirokastrës rezultojnë të jenë regjistruar 2 çështje penale me palë gazetarë dhe punonjës medie. Të dyja çështjet lidhen me veprën penale të shpifjes, ku për njërin është marrë vendim pafajësie në favor të gazetarit, ndërsa tjetra është ende në proces shqyrtimi. Ndërkohë Gjykata e Shkodrës, Gjykata e Beratit dhe Gjykata e Tiranës kanë referuar se, referuar metodologjisë së punës së tyre për grumbullimin dhe përpunimin e të dhënave nuk procedohet me specifikim të çështjeve gjyqësore me palë gazetarët apo përfaqësues të medias⁴³.

Përgjatë një studimi tjetër të realizuar në Qershor 2022 nga Instituti Shqiptar për Studime Ligjore dhe Territoriale lidhur me “Studimin mbi çështjet gjyqësore penale dhe civile me palë gazetarë dhe/ose përfaqësues të medias në kuadër të garantimit të një politike të tolerancës zero për frikësimin dhe sulmet ndaj gazetarëve”, është trajtuar më vëmendje çështja e krijimit të një mjedisi mediatik të sigurtë ndaj frikësimit, presionit apo sulmit të gazetarëve⁴⁴. Sipas databazës të historikut të të dhënave të grumbulluara e të përpunuara me palë gazetarë apo përfaqësues të medias rezultojnë se, paditë e ngritura pranë Gjykatave kanë patur si subjekte paditëse në 60% të tyre politikanë, biznesmenë apo përfaqësues institucionesh.

⁴² Për më tepër shih: <https://ahc.org.al/wp-content/uploads/2021/10/Barometri-Kombetar-per-Lirine-e-Media-2020.pdf>, f. 28.

⁴³ Gjendet po aty.

⁴⁴ Për të vizituar faqen zyrtare të A.L.T.R.I shih: <https://altri.al/?lang=en>, lexuar së fundmi në 09.08.2022.

6. Etika në media

Etika në fushën e gazetarisë është element esencial i përcjelljes së informacioneve në mënyrë të përgjegjshme, korrekte, si dhe konform sjelljes qytetare. Zhvillimet e fundit dhe inovative në fushën e medias kanë sjellë situata problematike në opinionin publik, të cilat në një pjesë të mirë të tyre lidhen me etikën gazetareske. Respektimi i etikës gazetareske është në vetvete dhënia e informacioneve të sakta për publikun e gjerë, por gjithmonë nën dritën e respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Etika profesionale e gazetarëve duhet t'i shoqërojë këta të fundit gjatë gjithë kohës së ushtrimit të detyrës së tyre. Referuar gazetarisë shqiptare dhe etikës, gazetarët shqiptarë duhet të respektojnë në çdo detaj të tijin Kodin Etik të Gazetarëve Shqiptarë dhe elementët rregullues të tij, të cilët lidhen me saktësinë dhe ndershmërinë e informacionit, dallimin e fakteve nga opinionet, korrektimet dhe replikat, marrëdhëniet me burimet, pavarësinë editoriale, marrëveshjet para publikimit, përgjegjësinë pas publikimit, gjuhën e urrejtjes, ndërhyrjen në jetën private, konfliktet e interesit, raportimin e aksidenteve dhe fatkeqësive, raportimin e procedurave gjyqësore dhe prezumimin e pafajësisë, mbrojtjen e fëmijëve dhe të personave me aftësi të kufizuara, të drejtat e pronësisë intelektuale, marrëdhëniet mes gazetarëve, interesin publik, si dhe respektimin e gjuhës shqipe⁴⁵. Kodi etik nuk është gjë tjetër veçse një grumbull normash dhe parashikimesh lidhur me rregulla etike për gazetarët përgjatë ushtrimit të detyrës së tyre. Zbatimi i standardeve etike të parashikuara në këtë kod rrit cilësinë dhe garancinë në ofrimin e informacioneve të sigurt dhe të para-verifikuara, përpara bërjes publike të tyre.

Etika në media është e lidhur në proporcion të drejtë me vlerën e cilësisë së ofruar në informacion. Sipas “Citizens Channel” Këshilli Shqiptar i Medias pas një monitorimi të kryer ndaj 30 mediave online, përfshirë edhe faqet zyrtare të televizioneve ka vërejtur se, në vendin tonë kryhen 8-9 shkelje të etikës në ditë⁴⁶.

Organi, puna e së cilit lidhet me angazhimin e etikës në median shqiptare është Këshilli Shqiptar i Medias. Njëkohësisht Këshilli Shqiptar i Medias dhe Instituti Shqiptar i Medias janë hartues të Kodit Etik të Gazetarëve. Pranë këtij Këshilli funksionon një Bord Etike i Aleancës

⁴⁵ Për më tepër informacion rreth Kodit Etik të Gazetarëve shih: <https://kshm.al/kodi-i-etikes-se-gazetarit/>, lexuar së fundmi në 09.08.2022.

⁴⁶ Vizito për më shumë informacion: <https://citizens-channel.com/2020/08/13/etika-ne-media-gazetarët-dhe-redaktoret-te-prirur-drejt-klikimeve-dhe-jo-cilesise/>, lexuar së fundmi më 11.08.2022.

për Media Etike, në të cilin merren vendime nga anëtarët e tij, sa herë iu përcillen ankesa lidhur me etikën në media.

Sipas Kodit Etik të Gazetarëve, shpifja si vepër është e dënueshme dhe masat, të cilat merren në të tilla raste janë gjoba. Në Kod parashikohet e drejta e korigjimit në rast se, ka paraqitje apo publikim të një informacioni të paqartë, jo të plotë ose mashtrues⁴⁷. Po ashtu, çdo individ, i cili ka pësuar dëm në nderin apo personalitetin e tij mund të kërkojë kompensim. Vënia në rrezik e paqes publike duke nxitur urrejtje kundrejt popullatës, duke i fyer ose shpifur, ose duke kërkuar përdorimin e forcës apo kryerjen e veprimeve arbitrare ndaj tyre, përbën vepër penale të dënueshme me burgim. Përhapja e informacionit apo lajmit të rremë, me fjalë, me shkrim apo në çfarëdo mënyre tjetër, për të nxitur një gjendje pasigurie apo paniku te njerëzit, dënohet me gjobë ose me burgim.

Një vendim mjaft interesant i Bordit të Etikës gjatë vitit 2021 lidhet me një debat të njohur në opinionin publik⁴⁸. Çështja i referohet debatit në studio mes një moderatoreje dhe një aktivisteje për të drejtat e komunitetit LGBT për të hequr fjalën “nënë” nga Kodi i Familjes dhe për t’u zëvendësuar këtë të fundit me “prindi që lind”⁴⁹. Subjekte ankuese në Bordin e Etikës ishin Historia Ime dhe Aleanca LGBT, kundër artikullit të botuar nga portali online “NewsBomb.al”. Sipas vendimit përfundimtar të bordit: *“Artikulli përmban shkelje të etikës pasi keqinformon lidhur me subjektin, i cili ka bërë kërkesën për heqje të termit në studion televizive. Po ashtu, përmbajtja e deklaratave të kryera në emision janë nxjerrë jashtë konotacionit në të cilin janë thënë duke nxitur gjuhë urrejtjeje për komunitetin LGBTI. Nëqoftëse një artikull citon burime të paverifikuara dhe jo të vërteta, është detyrë e portalit tjetër, i cili ri-publikon këtë artikull, që të ri-verifikojë burimet dhe saktësinë e informacionit të publikuar”*. Ky vendim është mjaft interesant pasi analizon edhe rastet kur një portal, ri-publikon përmbajtje të njëjtë artikulli me atë të një portali tjetër, qoftë ky informacion i verifikuar për nga burimi ose jo. Siç shihet, efekti negativ i informacioneve të marra nga burime jo të sakta, çorientuese për publikun dhe të paverifikuara krijojnë “efektin zinxhir”, ku gabimet e pafalshme të etikës gazetareske të një portali, pasojnë tek një tjetër portal, duke rritur perceptimin tek qytetarët për një gazetari mashtruese dhe me informacione të rreme.

⁴⁷ Gjendet po aty.

⁴⁸ Lidhur me vendimin nr. 27/2021 të Bordit të Etikës dhe për më tepër informacione shih: <https://kshm.al/2021/06/25/bordi-i-etikes-vendim-nr-27/>, lexuar së fundmi më 09.08.2022.

⁴⁹ Për detaje lidhur me artikullin e publikuar lexo: <https://newsbomb.al/te-hiqet-fjala-nene-debat-ne-studio-moderatorja-tafani-i-kthehet-xheni-karajt-une-jam-grua-dhe-nene-ti-e-degjeneron-shoqerine/>, lexuar së fundmi më 09.08.2022.

Raste të mungesës së etikës i hasim në mos-respektimin e të dhënave personale të një individi⁵⁰, situatave të lidhura me kriminalitetin në vend⁵¹, gjendjeve delikate ku është raportuar për përdhunim/dhunim të një individi të caktuar⁵², rasteve ku është përdorur gjuhë fyese/diskriminuese apo urrejtjeje etj⁵³, si dhe rasteve ku gazetarët apo përfaqësues të tjerë të medias nuk kanë respektuar kodin etik lidhur me veshjen.

Domosdoshmëria e lartë e disa portaleve të vogla për të bërë sa më shumë klikime të përkthyer në para, bën që këto të fundit të shpërndajnë me vetëdije dhe jo-etikisht informacione të rreme, të pasakta dhe të dala jashtë kontekstit të përmbajtjes së tyre, vetëm që këto të fundit të tërheqin lexuesin për t'i klikuar ato. Sipas anëtarit të Këshillit Shqiptar të Medias, z. Koloreto Cukali *“Dëshira për të marrë klikime dhe shikueshmëri kërkon që ti të abuzosh me tituj dhe me lajmin, që ta bësh sa më joshës dhe tërheqës duke shkelur etikën”*⁵⁴.

Një vendim tjetër interesant i Bordit të Etikës është ai lidhur me një ankesë nga znj. Valbona Sulçe kundër LAPSI.al referuar një artikulli të botuar me emërtesën *“Sfilata para Parlamentit, deputetja Gjylameti gafë me veshjen, nxjerr pjesët, që nuk do të donte t'i dukeshin”*⁵⁵. Ankesa është depozituar si shkak i faktit se, publikimi i materialeve të tilla prodhon gazetari me cilësi të keqe⁵⁶. Në kuadër të ankesës së bërë dhe të shkakut të sipër-cituar, bordi u shpreh se: *“Bordi nuk ka tagrin të gjykojë apo të etiketojë nëse një artikull duhet konsideruar gazetari e mirë apo e keqe, por vetëm nëse ka shkelje të etikës”*. Disa rezerva të anëtarëve të Bordit lidhur me këtë vendim lidheshin me disa pjesë ku: *“Gazetarët duhet të bëjnë kujdes që personazhet publikë të gjykojnë mbi punën, mbi politikëbërjen e jo mbi veshjen apo trupin pas lindjes.”*

⁵⁰ Shih për më tepër: <https://dritare.net/ngjarjet-e-dites/vetevrasja-tragjike-ne-kombinat-flasin-deshmitaret-e-jehovait-2>, lexuar së fundmi më 09.08.2022.

⁵¹ Për më shumë informacion: <https://sot.com.al/dossier/idajet-beqiri-mediat-tona-e-kthyen-mostro-C3%ABn-e-kor-C3%A7-C3%ABs-n-C3%AB-%E2%80%9Cromeon%E2%80%9D-e-fshatit>, lexuar së fundmi më 09.08.2022.

⁵² Shih për më shumë: <https://abcnews.al/deshmia-abazi-kreu-marredhenie-edhe-me-shoqet-e-mia-zgjerohet-skandali-i-abuzimit-me-te-miturat/> lexuar së fundmi më 09.08.2022.

⁵³ Lexo: <https://noa.al/lajmi/2022/05/2323733.html> lexuar së fundmi më 09.08.2022.

⁵⁴ Lexo për më tepër: <https://citizens-channel.com/2020/08/13/etika-ne-media-gazetaret-dhe-redaktoret-te-prirur-drejt-klikimeve-dhe-jo-cilesise/> lexuar së fundmi më 09.08.2022.

⁵⁵ Lexo vendimin nr. 26/2021 të Bordit të Etikës: <https://kshh.al/2021/06/25/bordi-i-ame-vendim-nr-26/> lexuar së fundmi më 10.08.2022.

⁵⁶ Për të vizituar artikullin e publikuar: <https://lapsi.al/2021/06/14/sfilata-para-parlamentit-blerina-gjylameti-gafe-me-veshjen-nxjerr-pjeset-qe-sdo-donte-ti-dukeshin/>, lexuar së fundmi më 09.08.2022.

6.1. Nevoja për vetërregullimin e medias

Ruajtja e pavarësisë lidhur me aspektin editorial, mungesa e censurës dhe e autocensurës, respektimi i standardeve lidhur me etikën, saktësia, transparenca maksimale në ofrimin e informacionit në publik, janë pjesë përbërëse të vetërregullimit të sektorit të medias dhe të nevojës që, ka kjo e fundit për t'u vetërregulluar dhe përmirësuar vazhdimisht. Vetërregullimi mbart si subjekte përfaqësuesit e komunitetit të medias, duke përfshirë këtu gazetarët, redaktorët, kryeredaktorët, mediat e mëdha dhe të vogla, si dhe pronarët e tyre, të cilët mbajnë si emërues të përbashkët vullnetin e mirë për të çuar zhvillimin e medias më tej nëpërmjet rritjes së cilësisë së ofrimit të shërbimeve nga ky sektor dinamik. Pikërisht, ky është një ndër të shumtat avantazhe të vetërregullimit të medias, pasi çdo procedurë, fazë ankimuese, çdo problematikë apo kritikë ndaj medias nga publiku merret dhe shqyrtohet nga profesionistët e kësaj të fundit. Dukshëm, kjo do të rriste edhe besimin në publik se, kur flasim për sektorin e medias, kemi një pavarësi të plotë të saj ndaj çdo influencimi politik apo qoftë edhe nga ana e bizneseve. Sipas Udhëzuesit të Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë për Lirinë e Medias, vetërregullimi nxit krijimin e standardeve, duke ndikuar në ruajtjen e besueshmërisë së medias në publik⁵⁷. Referuar procedurave apo mekanizave me natyrë ankimuese, që mund të ngrihen në sajë të vetërregullimit, kjo do të sillte një qasje proaktive të profesionistëve të komunitetit të medias, në identifikimin e ankesave në këtë sektor, por edhe në marrjen e vendimeve legjitime, të cilat nxisin mediat në një punë më serioze të tyre. Vendimet, të cilat lidhen me korrigjime në informacionet e ofruara apo heqje përmbajtjeje në rast se, cenohet dinjiteti, të dhënat personale të një individi tjetër qoftë ky publik apo privat, përmirësojnë cilësinë gazetareske dhe bëjnë të mundur një gjykim profesional nga anëtarë të komunitetit të medias, për çështje që lidhen me median.

Ofrimi i garancive lidhur me sigurinë dhe besueshmërinë e informacionit të publikuar nga gazetari është më i lartë në një sektor mediatik të vetërregulluar, korrekt në respektimin e aspektit editorial dhe në ofrimin e mekanizmave të ankimit, sesa në një media të politizuar dhe të përfshirë nga keqinformimi e lajmet e rreme në favor të aktorëve politikë apo bizneseve të ndryshme.

⁵⁷ Për më tepër detaje të Udhëzuesit të Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë lidhur me Vetërregullimin në Media lexo: <https://www.osce.org/files/f/documents/c/e/31500.pdf> lexuar së fundmi më 10.08.2022.

Natyrisht që, pjesë e këtij procesi, si dhe për të rritur cilësinë e këtij sektori në aspektin profesional, duhet të jenë organizata të shoqërisë civile apo organizata të tjera, me qëllimin e mirë për të kontribuar në zhvillimin e mëtejshëm të kësaj fushe. Vetërregullimi sjell me vete një media më të përgjegjshme dhe totalisht të pavarur nga synimet qeveritare apo ndërhyrjet abuzive të shtetit.

6.1.1. Gjuha e urrejtjes

Zhvillimi i vrullshëm i teknologjisë ka sjellë trajta të reja të shkeljes së etikës së gazetarëve, sidomos në fushën e përdorimit të gjuhës së urrejtjes nga gazetarë apo përfaqësues të ndryshëm të medias. Krahas këtyre zhvillimeve dhe evoluimit të internetit, si mekanizëm i marrjes së shumë informacioneve, rritet edhe sfida përballë përdorimit të gjuhës së urrejtjes për shkaqe që kanë të bëjnë me etnicitetin, orientimin seksual, identitetin gjinor, bindjet politike apo ato fetare. Balanca mes garantimit të të drejtës së shprehjes dhe të medias nga njëra anë dhe kufizimi i kësaj të drejte në rastet kur kjo e fundit përcjell gjuhë urrejtjeje, diskriminuese e paragjyquese apo keqpërdoret për të cenuar imazhin e figurën e një personi në mënyrë publike, e ka shtuar vëmëndjen ndaj debateve të shumta lidhur me lirinë e medias. Tejkalmi dhe shkelja e mbrojtjes së ofruar nga këto të drejta themelore nxit një mjedis shoqëror paragjyques dhe diskriminues, duke parë me skepticizëm e mosbesim rolin e medias në shoqëri. Padyshim që, dinamizmi i medias klasike dhe asaj elektronike, kanë sjellë me vete potencial të lartë të rritjes së riskut, që këto të fundit të dëmtojnë me anë të gjuhës së urrejtjes grupet e marginalizuara. Risku për të tejkaluar kufirin e gjuhës korrekte po bëhet gjithnjë e më i fortë⁵⁸.

Gjuha e urrejtjes edhe pse nuk ka një definicion zyrtar ligjor në kuadrin legjislativ rregullues shqiptar, por edhe në botë, mbetet e ndaluar⁵⁹. Në terma të përgjithshëm gjuha e urrejtjes përfshin nxitjen dhe promovimin e urrejtjes, përdorimin e termave fyese e denigrues, kryerjen e kanosjeve apo ushtrimin e dhunës ndaj një individi apo disa prej tyre. Sot, rrjetet sociale, portalet elektronike, media audiovizive apo shtypi konsiderohen burimet më përcjellëse të gjuhës së urrejtjes, duke patur impakt tek të gjithë qytetarët e sidomos tek të rinjtë.

⁵⁸Për më tepër detaje lidhur me gjuhën e urrejtjes dhe për informacione shtesë shih: https://www.osfa.al/sites/default/files/monitorimi_per_gjuhen_e_urrejtjes_ne_gazeta_dhe_media_online_3.pdf, lexuar së fundmi më 13.07.2022.

⁵⁹Federico, F.; Mirela, B.; Xheni, K., *Një studim gjithëpërfshirës “Thirrje Kundër Gjuhës së Urrejtjes”*, Tiranë, Nëntor 2021, <https://www.kmd.al/wp-content/uploads/2021/11/Manual-shqip.pdf>, lexuar së fundmi më 11.08.2022.

Në mënyrë periodike dhe me vëmendje të shtuar ndaj këtij fenomeni disa institucione të angazhuara në luftën kundër gjuhës së urrejtjes në Shqipëri janë: Avokati i Popullit, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Gjykatat, OSHC-të etj. Këto institucione ndihmojnë dhe mbështesin me anë të rekomandimeve të vazhdueshme që japin, në minimizimin dhe parandalimin e rasteve të përdorimit të gjuhës së urrejtjes. Edhe në raportet e tyre vjetore, janë këto institucione ato, të cilat i japin fokus tolerancës, sjelljes qytetare, si dhe respektit për individët e tjerë të komunitetit ku jetojmë. Në daljen e çdo rekomandimi, vendimi apo raporti vihet theksi tek dënimi i veprimit të nxitjes së gjuhës së urrejtjes, i cili përbën tejkalim në abuzim të së drejtës, që gëzon një individ lidhur me lirinë e shprehjes. Edhe në raportin për vitin 2021 të Komisionerit për Mbrojtjen Kundër Diskriminimit u theksua se: *“Në mbrojtje të të drejtave njerëzore dhe me synim krijimin e një mjedisi sa më miqësor në drejtim të këtij komuniteti apo të anëtarëve të tjerë të shoqërisë, organet kompetente si Policia dhe Prokuroria duhet të evidentojnë çdo rast me përmbajtje të tillë për të neutralizuar situatën, si dhe për t’u trajtuar çështjen në kuadrin e një vepre penale në abuzim të personave të ndryshëm si shkak i orientimit të tyre seksual⁶⁰”*.

Duke patur në konsideratë rregullimet ligjore të kryera në kuadrin ligjor shqiptar mbi gjuhën e urrejtjes edhe pse në mënyrë jo të drejtëpërdrejtë, duke nisur që nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Kodi Civil, Kodi Penal, Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Ligji për Median Audiovizuale, Ligji për Tregtinë Elektronike e deri tek Kodet e Brendshme të Sjelljes, do të parashtroja disa rekomandime lidhur me kontekstin ligjor të këtij fenomeni:

Së pari, rekomandoj që në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë të bëhet amendim, duke parashikuar si vepër penale konkrete përdorimin apo nxitjen e përdorimit të gjuhës së urrejtjes. Kjo do të bënte të mundur që, Policia dhe Prokuroria të kishin më të lehtë evidentimin e rasteve të tilla dhe t’i dënonin ato në mënyrë që, të arrihej parandalimi i fenomenit. Pavarësisht parashikimeve me natyrë indirekte tek gjuha e urrejtjes, Kodit Penal i nevojitet një amendim në këtë aspekt për të bërë më të qartë këtë vepër penale, objektin e saj, si dhe subjektet që mund të përfshihen në këtë vepër.

Së dyti, rekomandoj ofrimin e një përkufizimi në rang kombëtar mbi gjuhën e urrejtjes me anë të një akti normativ. Definicioni zyrtar i gjuhës së urrejtjes mbetet problem me natyrë ndërkombëtare pasi nuk ekziston një përkufizim i uniformizuar dhe i harmonizuar. Megjithatë,

⁶⁰ Shih: <https://www.kmd.al/statement-against-hate-speech-against-lgbti-activists/?lang=en>, lexuar së fundmi më 01.08.2022.

parashikimi i një definicioni do të lehtësonte evidentimin e rasteve me përmbajtje të tillë, trajtat që merr gjuha e urrejtjes dhe shkaqet për të cilat mund të përdoret, si dhe nënlojet e saj.

Së treti, referuar këtij fenomeni, është pjesë mjaft e rëndësishme aspekti i ndërgjegjësimit publik. Edukimi dhe mirë-arsimimi i brezave të ardhshëm është detyrë dhe përgjegjësi e çdokujt. Realizimi i trajnimeve të ndryshme apo i aktiviteteve të shumëllojshme me natyrë ndërgjegjësuese, do të ishte vlerë e shtuar në luftën kundër përdorimit të gjuhës së urrejtjes.

Së katërti, rekomandoj ngritjen e strukturave të veçanta me në fokus evidentimin, ndjekjen dhe kryerjen e studimeve lidhur me rastet e shfaqjes së gjuhës së urrejtjes. Këto struktura duhet të jenë të specializuara dhe me staf të mirë-trajnuar në këtë fushë. Përdorimi nga këto struktura e një databaze lidhur me rastet e evidentuara në mënyrë periodike, si dhe vijimi i trajtimit të tyre kur për to ngrihet padi në gjykatë, do të ishte një ndihmesë e madhe.

Së pesti, rekomandoj vijimin e bashkëpunimit të institucioneve, të cilat kanë në fokus të veprimtarisë së tyre luftën ndaj këtij fenomeni. Bashkëpunimi i thelluar, sidomos i Institucionit të Avokatit të Popullit, A.M.A-së, Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, do të rriste kapacitetet për të minimizuar këtë fenomen, si dhe për t'a parandaluar këtë të fundit.

Së fundmi, rekomandoj që, Aleanca Kundër Gjuhës së Urrejtjes të rrisë reagimet e saj publike, duke marrë në konsideratë se, rastet e evidentuara lidhur me gjuhën e urrejtjes për shkaqe përkatësie, orientimi seksual, identiteti gjinor, besimi fetar apo politik janë rritur në mënyrë të ndjeshme përgjatë periudhës Mars-Korrik 2022. Vëmendje duhet treguar më shumë në portalet sociale, si dhe emisionet televizive, të cilat “po prodhojnë” tej mase gjuhë urrejtjeje dhe raste të faktuara të këtij fenomeni.

6.1.1.1. Evidentim i rasteve të përdorimit të gjuhës së urrejtjes përgjatë muajve Mars-Korrik 2022 në media apo përfaqësues të ndryshëm të ftuar në studio televizive.

Në kuadër të monitorimi të kryer nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit lidhur me përdorimin e gjuhës së urrejtjes për shkaqe përkatësie, orientimi seksual, identiteti gjinor, besimi fetar e bindjeje politike, për periudhën Mars-Korrik 2022 është bërë i mundur evidentimi konkret i përdorimit të gjuhës së urrejtjes nga media apo përfaqësues të ndryshëm të ftuar në studio televizive.

Kryesisht në vëmendje të këtij monitorimi janë disa gazeta, emisione televizive, portale online apo media sociale të njohura si: gazeta “Gazeta Shqiptare”, gazeta “Fjala”, emisioni “Ditë e Re” Ora Tv, “TEMA”, portali “SHENJA”etj.

Referuar elementit të parë të gjuhës së urrejtjes me bazë përkatësinë etnike, në gazetën “Fjala” është publikuar një material nga z. Sebi Alla me titullin “*Shqiptarët apo Kosovarët, kush janë më të mirë?*”⁶¹. Ky titull pasqyron ndasi mes dy vendeve dhe përcjell tek lexuesi idenë e përçarjes mes Shqipërisë-Kosovës. Materiali i publikuar nën autorësinë e zotit Alla pavarësisht se, është kritik ndaj qasjes, që kanë sfera evropiane dhe ajo ndërkombëtare ndaj Shqipërisë dhe Kosovës, duke i trajtuar të ndara në shumë aspekte, përdor një gjuhë jo-korrekte dhe aspak etike si: “*Dikush përfitoi, ndonjë derr në këtë “pyll” që jemi*”, “*Na yshti shkjau*”, “*...Ngrenë mure të trashë që të pushtetojnë si “pushta” mbi shpinën e shoqërisë që drejtojnë*”.

Sa i përket elementit të gjuhës së urrejtjes bazuar në bindjet politike, Shqipëria në këtë aspekt po bëhet gjithnjë e më shumë aktive. Sipas gazetës “Fjala” është publikuar nga z. Nebil Çika një material, i cili i referohet protestës së realizuar në datën 07.07.2022 në Tiranë nga disa deputetë dhe politikanë të PD-së. Titulli i materialit të publikuar është “*Langaraqë*” dhe siç shihet tejet ofendues në drejtim të emrave konkretë, anëtarë apo kryetarë partish politike në vend⁶². Duke kritikuar me shumë ashpërsi protestën e thirrur në drejtim të të gjithë qytetarëve kudo që ata ndodheshin, zoti Çika ka përdorur terma ofendues si “*...Justifikime bajate që t’i sjellin zorrët në grykë*” “*Këta lëngaraqë, më shumë se politikë, që përpiqen më kot të fshihen mbas gishtit*”.

Sa i përket elementit të gjuhës së urrejtjes bazuar në orientimin seksual të një individi të caktuar në emisionin televiziv “*Shqipëria Live*” është publikuar një intervistë e një personi homoseksual, i cili ka treguar se, për hir të orientimit të tij seksual ka pësuar gjuhë urrejtjeje deri në cenim të lartë të të drejtave të njeriut⁶³. Sipas të intervistuarit, një deputete e Lëvizjes “*VETËVENDOSJA*”, emri i së cilës u la anonim, është shprehur se: “*Homoseksualët janë të shthurur, derra*”... “*Homoseksualët janë imoralë*”... “*Homoseksualiteti është sëmundje*”⁶⁴. E gjithë intervista është realizuar në kuadër të propozimit për miratim të një ligji, i cili do të

⁶¹ Lexo për më tepër detaje: <https://fjala.al/2022/07/09/shqiptaret-apo-kosovaret-kush-jane-me-te-mire/>, lexuar së fundmi më 13.07.2022.

⁶² Shih për më shumë hollësi: <https://fjala.al/2022/07/07/lengaraqe/>, lexuar së fundmi më 13.07.2022.

⁶³ Shih për më tepër: <https://www.youtube.com/watch?v=wJS4qLTWgoc>, klikuar së fundmi më 13.07.2022.

⁶⁴ Për më shumë vizito: <https://top-channel.tv/>, lexuar së fundmi më 13.07.2022.

mundësonte dhe do të njihje ligjërisht martesat homoseksuale. Ishte pikërisht ky mos-miratim i ligjit, i cili nxiti debate të shumta në rrjet dhe jo vetëm.

Referuar gjuhës së urrejtjes të përdorur për sa i përket çështjeve të identitetit gjinor, në “Gazeta Shqiptare” në prill të vitit 2022 u publikua një material me titullin “Refuzoi transgjinoren në film/ Gentian Zenelaj shpjegon çfarë ndodhi gjatë audicionit”⁶⁵. I riu Luan Myrtollari i kthyer tashmë në një transgjinore deklaroi në emisionin “Ditë e re” në RTV ORA se, kishte shkuar në audicion për të bërë rolin e një vajze, por Gentiani nuk kishte pranuar pasi kishte thënë se nuk dëshironte që të gënjente publikun. Sipas Gentianit u tha se: “Nuk e shisja dot si gjini femërore në ekran, pavarësisht se, mund të ishte drejt asaj rruge”. Si shkak i këtyre ndryshimeve në identitetin gjinor transgjinorja shprehu se, e kanë paragjykuar sidomos personazhet publike, kur vjen fjala tek bashkëpunimet.

Nga portali elektronik “Shqiptarja.com”, është bërë publik një material me emërtesën “Bardhi përplasjet me Manjën te ‘Ligjet’: Ti je vrasës dhe duhet të ishe në burg! Ministri i Drejtësisë: S’i kam duart e lyera me gjak”⁶⁶. Titulli, jo vetëm është tejet ofendues duke arritur deri në cënim të personalitetit të individit, por edhe përdor gjuhë urrejtjeje të ashpër për shkak të bindjeve të ndryshme politike që personat kanë.

Referuar gjuhës së urrejtjes së përdorur mbi bazë përkatësie apo etniciteti sipas portalit “SHENJA” është publikuar një artikull në të cilin pasqyrohet përdorim i gjuhës së urrejtjes ndaj policëve me prejardhje shqiptare⁶⁷. Emërtesa e artikullit ishte “Fyerje në bazë etnike ndaj policëve shqiptarë, partitë politike dënojnë dhunën gjatë protestave”. Bëhet fjalë për protestën e VMRO-DPMNE-së dhe “Levicës”, kundër propozimit francez. Sipas artikullit në fjalë: “Në protestën e dhunshme gjatë mbrëmjes së kaluar nuk ka munguar as gjuha e urrejtjes, ku janë dëgjuar sharje ndaj policëve shqiptarë, që ishin në detyrë për mbrojtjen e institucionit ligjvënës. Protestuesit kanë sharë dhe fyer në baza etnike policët shqiptarë”.

⁶⁵ Lexo për më shumë informacion: http://gazetashqiptare.al/2022/04/21/refuzoi-transgjinoren-ne-film-gentian-zenelaj-shpjegon-çfare-ndodhi-gjate-audicionit/?fbclid=IëAR34oWDdP4qIJB3q-Zi_QC-Y0n1AkY68aZUrtcÉ4HĒFQ8ĒY9toaQoBkQhco, lexuar së fundmi më 13.07.2022.

⁶⁶ Për më tepër shih: <https://shqiptarja.com/lajm/seance-degjimore-per-harten-e-re-gjyqesore-cupi-te-mos-politizohen-as-socialistet-sjane-dakord-por-se-shprehin-ne-media#659375>, lexuar së fundmi më 20.07.2022.

⁶⁷ Lexo për më shumë: <https://shenja.tv/video-fyerje-ne-baze-etnike-ndaj-policëve-shqiptarë-partite-politike-denojne-dhunën-gjate-protestave/>, lexuar së fundmi më 25.07.2022.

Nga analiza e mësipërme vihet re se, rastet më të shpeshta të përdorimit të gjuhës së urrejtjes, ndeshen kryesisht në lajmet dhe informacionet lidhur me zhvillimet politike në vend apo qasjet e shfaqura nga personat pjesë të komunitetit LGBTI.

7. Rekomandimet

Rekomandimet, të cilat mund të jepen për përmirësimin e problematikave në fushën e lirisë së medias, si dhe në garantimin e kësaj të drejte, si një nga të drejtat themelore të njeriut në kuadër të forcimit të shtetit të të drejtës, vijnë:

Së pari, nevojitet fokusi i organizatave të shoqërisë civile dhe i strukturave përgjegjëse kombëtare në evidentimin e rasteve të sulmeve verbale e fizike ndaj gazetarëve apo përfaqësuesve të ndryshëm të medias, në mënyrë që të realizohet mbrojtje efikase dhe e menjëhershme e këtyre subjekteve.

Së dyti, ofrimi i sigurisë përgjatë ushtrimit të profesionit të gazetarit është një ndër elementët primarë, i cili duhet përmbushur me korrektësi nga çdo media.

Së treti, është i domosdoshëm dhe i nevojshëm përafrimi e harmonizimi me legjislacionin e *acquis communautaire* me qëllim garantimin e një mjedisi të sigurtë mediatik dhe për të rritur cilësinë e informacioneve të publikuara.

Së katërti, garantimi i pavarësisë së Autoritetit të Mediave Audiovizive për t'a shkëputur atë nga partitë politike realizohet duke kryer ndryshimet legjislative të nevojshme. Përzgjedhja e anëtarëve të këtij autoriteti nga përfaqësues të komunitetit të gazetarisë dhe jo nga Kuvendi, do të shmangte drejtëpërdrejtë influencën e politikës në media.

Së pesti, është e nevojshme të rritet profesionalizmi, zbatimi i etikës dhe cilësia gazetareske. Gjithashtu, vëmendje e veçantë i duhet kushtuar gazetarisë investiguese. Publikut të gjerë duhet t'i jepet informacion i vërtetë dhe i verifikuar paraprakisht me qëllim korrektësinë dhe seriozitetin në dhënien e informacioneve të panjohura më parë.